



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 maj 2014
Nr. ref.: RK623/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI08/14

Parashtrues

Skënder Gashi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 118/2010, të 4 marsit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Skënder Gashi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në komunën e Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 118/2010, të 4 marsit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij më 23 shtator 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 118/2010, të 4 marsit 2013, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit, ishin shkelur nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 janar 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 shkurt 2014, Kryetari me Vendimin nr. GJR. K108/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. K108/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 5 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 27 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 25 prill 1979, Komuna e Klinës, me Aktvendimin 04-462-2/2, e eksproprijoi një pjesë të ngastrës kadastrale, nr. 1911, në sipërfaqe prej 0.06,79 ha, bazuar në kontratën për shitblerje, të vërtetuar me numër 504/75, të 7 dhjetorit 1975, nga pronësia e parashtruesit, e regjistruar në fletën poseduese nr. 220 ZK - Dresnik.

10. Më 26 prill 1979, Komuna e Klinës, me Aktvendimin 04-462-2/2, e eksproprijoi një pjesë të ngastrës kadastrale, nr. 1900/3, në sipërfaqe prej 0.03.70 ha nga parashtruesi, e cila sipas regjistrimit në fletën poseduese nr. 360 ZK-Dresnik, ishte në pronësi të parashtruesit.
11. Më 29 qershor 1979, Komuna e Klinës, me Aktvendimin 04-462-2/2, e eksproprijoi një pjesë të ngastrës kadastrale nr. 1908, në sipërfaqe prej 0.07,30 ha, e cila sipas regjistrimit në fletën poseduese nr. 321 ZK-Dresnik, ishte në pronësi të vëllait të parashtruesit, tani të ndjerit Hamit Gashi. Më 14 maj 2001, parashtruesi, në bazë të kontratës për ndërrimin, Leg. nr. 658/2001 u bë pronar i kësaj parcele.
12. Bazuar në tri vendimet e lartcekura, Komuna e Klinës eksproprijoi një sipërfaqe të përgjithshme prej 00.17,79 ha, për ndërtimin e objekteve banesore si dhe të rrugëve.
13. Më 19 korrik 2002, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Klinë, që Komuna e Klinës t'ia kompensojë atij një vlerë monetare ekuivalente me pronën e eksproprijuar, sepse ai nuk është kompensuar për këtë paluajtshmëri, ose si alternativë, t'i ndahet atij një tokë ndërtimore-urbane me vlerë ekuivalente për përdorim të përhershëm në Klinë.
14. Më 24 janar 2008, Gjykata Komunale në Klinë, me Aktgjykimin C. nr. 150/2006, e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit dhe urdhëroi si në vijim:

“DETYROHET e paditura Komuna e Klinës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit për tokën e eksproprijuar, ti ndaj paditësit Skënder Gashi, nga Klina, tokë urbane ndërtimore në shfrytëzim të përhershëm në qytetin e Klinës, në vendin ku jepet leja e ndërtimit, në sipërfaqe prej 00.17,79 ha, në të kundërtën, në pamundësi të ndarjes së tokës urbane ndërtimore për të cilën jepet leja e ndërtimit, t'ia paguaj në emër të kompensimit të kundërvlerës së tokës së eksproprijuar në sipërfaqe prej 00.17,79 ha, shumën në lartësi prej 266.930,00 euro, me kamatë ligjore të cilën Bankat afariste në Kosovë, ua paguajnë klientëve të tyre për mjetet e deponuara, duke filluar nga data 03.06.2005, e deri ne pagesën definitive”.

“E paditura detyrohet poashtu që brenda të njëjtit afat paditësit tia kompensoj edhe dëmin e shkaktuar me prishtjen e trupave të pemëve në tokën e eksproprijuar në lartësi prej 10.080,00 euro, poashtu me kamatë ligjore, duke filluar nga data 03.06.2005, e deri në pagesën definitive”.

“E paditura detyrohet që brenda të njëjtit afat paditësit tia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 2.605 euro”.

15. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë, C. nr. 150/2006, të 24 janarit 2008, Komuna e Klinës, si e paditur, në kohë ushtroi ankesë, duke pretenduar shkeljen thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe

kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, ose e njëjta të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

16. Më 12 prill 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 220/08, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Klinë, C. nr. 150/06, të 24 janarit 2008, dhe urdhëroi si në vijim:

"RREFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Skënder Gashi nga Klina, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Klinës, në afat prej 15-ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në emër të kompensimit për tokën e eksproprijuar ti ndaj paditësit tokë urbane ndërtimore në shfrytëzim të përhershëm në qytetin e Klinës, në vendin ku jepet leja e ndërtimit në sipërfaqe prej 00.17,79 ha, në të kundërtën në pamundësi të ndarjes së tokës urbane ndërtimore për të cilën jepet leja e ndërtimit ti paguaj në emër të kompensimit të kundërvlerës së tokës së eksproprijuar në sipërfaqe prej 00.17,79 shumën në lartësi prej 266.930,00-€ me kamatë Ligjore të cilën Bankat Afariste ua paguajnë klientëve të tyre për mjetet e deponuara duke filluar nga data 3.06.2005 e deri në pagesën definitive si dhe të detyrohet e paditura poashtu që brenda të njëjtit afat, paditësit tia kompensoj edhe dëmin e shkaktuar me prishjen e trupave të pemëve në tokën e eksproprijuar në lartësi prej 10.080,00-€, me kamatë Ligjore duke filluar nga data 3.06.2005 e deri në pagesën definitive e poashtu në emër të procedurës kontestimore ti paguaj shumën prej 2.605-€".

17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 220/08, të 12 prillit 2010, parashtruesi ushtroi revizion brenda afatit kohor, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 220/08, i 12 prillit 2010, të ndryshohet, ashtu që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, C. nr. 150/2006, i 24 janarit 2008, do të mbetet në fuqi.

18. Më 4 mars 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 118/2010, e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 220/2008, të 12 prillit 2010, me arsyetimin si në vijim:

"Në procedurën ankimore gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se gjendja faktike në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar drejt, por gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, prandaj në bazë të nenit 373 par. 1 pika 4 të LPK, ka ndryshuar aktgjykimin e goditur dhe ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar".

"Gjykata Supreme e Kosovës, duke i pranuar në tërësi thëniet e qëndrimit juridik të arsytimit të gjykatës së shkallës së dytë, vlerëson se drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit".

"Sipas nenit 371 të LMD, i ndryshuar me nenin 58 të Ligjit mbi plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji, afati i përgjithshëm i parashkrimit të kërkesës është 10 vjet. Aktvendimet e cekura mbi eksproprijimin datojnë nga viti

1979, ndërsa padia është paraqitur më 19.7.2002, që do me thënë, pas 23 vjetëve. Kjo Gjykatë shton se paditësi nuk e ka mohuar faktin se e paditura ka hyrë menjëherë në posedim dhe në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi eksproprijimin, shfrytëzuesi i ekspropriimit e fiton të drejtën e posedimit në pasurinë e patundshme të ekspropriuar në ditën kur vendimi të merr formën e prerë, ndërsa sipas nenit të cekur, përjashtimisht në bazë të kërkesës së propozuesit i cili ka paraqitur dokumentin se i ka siguruar mjetet e pagimit ka mundur pasuria të dorëzohet në atë posedim, nëse rasti ka qenë urgjent, dhe kundër këtij aktvendimi ka mundur të zhvillohet konflikt administrativ”.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale dhe gabimisht ka llogaritur afatin e parashkrimit. Ai pretendon se:

“Është notore se me datën 22.03.1989, duke aprovuar kushtetuten e saj, ish pushteti i Serbisë kishte suprimuar autonomin e Kosovës, organet e saj dhe sistemin ligjor dhe në kushte të këtilla kur ligjet ekzistuese të Kosovës sipas të cilave çështja e paditësit trajtohej në procedurë para organit kompetent të administratës komunale, janë suprimuar, në ndërkohë që edhe puna e organit është pezulluar, është krijuar një situatë juridike kur për shkaqet ligjore diskriminuese, në çështjen juridike në shqyrtim të paditësit, zyrtarisht nuk është ndërmarrë asnjë veprim, nuk do të duhej të llogaritet në vjetërsim. Këtë për faktin se me riorganizimin e pushtetit pas luftës, për shkak të ndryshimit të sistemit, ka ndryshuar edhe natyra e trajtimit të çështjeve, andaj koha e kaluar prej datës 22.03.1989 e në vazhdim, duke llogaritur edhe kohën e luftës dhe atë të pas luftës e deri në ngritjen për herë të dytë të padisë, nuk do të duhej të llogaritej një vjetërsim i tillë, kështu që nëse para luftës kanë ekzistuar pengesa ligjore të instaluar nga pushteti diskriminues, tani për shkak të ndryshimit të sistemit vazhdojnë të jenë dispozita të një natyre krejtësisht tjetër”.

20. Në bazë të asaj që është paraqitur në kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të:

“... aprovohet parashtrësia e paditësit (...), ndërsa aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.118/2010 i datës: 04.03.2013 të hudhet poshtë si i pa bazuar dhe i paligjshëm, çështja ti rikthehet gjykatës kompetente në rigjykim dhe rivendosje ose të bëhet përsëritja e procedurës kontestimore në bazë të shkresave dhe provave materiale të bashkëngjitura kësaj parashtrëse të cilat paraqesin pjesën përbërëse të kësaj lënde kontestimore”.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj” .

24. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

25. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe mënyrës së gabuar të llogaritjes së afateve, Gjykata Kushtetuese rithekson se ajo nuk është gjykatë apeli, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1). Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 220/08, i 12 prillit 2010 dhe Aktvendimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 118/2010, i 4 marsit 2013, në arsyetimet e tyre kanë arsyetuar në mënyrë të detajuar dhe kanë siguruar përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit.

26. Gjykata Kushtetuese rithekson se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

27. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë

mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/ 06, të 30 qershorit 2009).

28. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me dëshmi se me vendimin e kontestuar i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.
29. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, më 27 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani